



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY

Ref: AUV, 01-207/2017
Datë: 18.07.2017


Kryeshefi Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratë Shtetërore të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 8, paragrafi 8.1, 8.2 dhe Listës së Programit të parë të Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë dhe merr këtë:

V E N D I M

- I. Me rastin e fillimit të fushatës së vaksinimit masiv të gjedheve kundër Sëmundjes Gungore të Lëkurës, **OBLIGOHEN** të gjitha Komunat në territorin e Republikës së Kosovës që në bashkëpunim me AUV-në dhe subjektet veterinare të licencuara në komunat përkatëse të ndërmarrin këto masa:
 - a) Mbyllja dhe ndalimi i funksionimit të tregjeve të kafshëve;
 - b) Ndalimi i përkohshëm i lëvizjes së kafshëve;
 - c) Vizita e fermave të dyshuara;
 - d) Njoftimi i rasteve të dyshimta për Sëmundjen Gungore të Lëkurës;
 - e) Në rast të shpërthimit të sëmundjes të bëhet dezinfektimi i stallave dhe
 - f) Caktimi i lokacioneve dhe groposja e kafshëve të ngordhura (përgjegjësi e komunave).
- II. Përrjashtimisht nga pika I e këtij vendimi, lejohet lëvizja kafshëve, tufave nga ferma në therrtore apo nga ferma në fermë vetëm me pëlqimin e veterinarit zyrtar të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe veterinarit të autorizuar nga AUV-ja.
- III. Urdhërohen të gjithë menaxherët e tregjeve që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi të pezullojnë punën për pranimin e kafshëve në hapësirat e tyre.
- IV. Për këto masa komunat duhet të njoftojnë Policinë e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi nga data 19.07.2017.

Vendimi t'i dërgohet:

- Kryetarëve të Komunave,
- MBPZHR,
- Inspektoratit të AUV-së,
- Policisë së Kosovës,
- Arkivit të AUV -së dhe
- Të publikohet në web-faqen e AUV-së


Valdet Gjinovci
Kryeshef Ekzekutiv i AUV-së